

Policia jep detaje për vrasjen në Prizren, i dyshuari në arrati



Foto: Ilustrim

Policia e Kosovës ka dhënë detaje lidhur me vrasjen që ka ndodhur të dielën në Prizren.

4 shtator 2023, 09:06

Shpërndaje në




Sipas raportit të Policisë dyshohet se vrasja ka ndodhur pas një mosmarrëveshjeje që kanë pasur mes vete viktima dhe i dyshuari.

"Prizren 03.09.2023-18:45. Dyshohet se i dyshuari mashkull kosovar pas një mosmarrëveshjeje që kishte pasur me viktimën mashkull kosovar, ka shtënë me armë zjarri në drejtim të tij. Si pasojë e plagëve të marra viktima ka ndërruar jetë. Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet policore, prokurori kujdestar dhe ekipi mjekësor i cili ka konstatuar vdekjen e viktimës", thuhet në raportin e Policisë.

Me vendim të prokurorit, thuhet se trupi i pajetë i viktimës është dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore për obduksion.

Sipas Policisë i dyshuari gjenden në arrati.

"Ndërsa njësitet policore kanë kryer disa bastisje në lokacione të ndryshme në kërkim të vendndodhjes së të dyshuarit i cili është në kërkim policor. Lidhur me rastin janë duke u kryer hetime intensive", thuhet në raportin e Policisë.



© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#POLICIA #VRASJE #PRIZREN

Taboola Feed



Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie

Blog | Sponsored

Lexo më shumë



Albania Citizens Can sign up for Canada Permanent Resident Card

Canada Immigration | Search Ads | Sponsored



Lituania tregon se si mund të mposhtet SHBA-ja

Për herë të parë që nga viti 2002, SHBA-ja ka pësuar humbje në fazën grimore të Kupës së Botës në basketboll. Lituania kreu punën e saj në parket. Fitoi respektin e botës së këtij sp...

Kohantet




Here's What Liposuction In Albania Might Cost You!

Liposuction | Search Ads | Sponsored

TË TJERA




Rrahje mes vëllezërve në Ferizaj, njëri sulmoi edhe nënën



Vlorë, 23-vjeçari vret babanë me eksploziv



Shqiptari dhe 23-vjeçarja përballen me burgim të përjetshëm për vrasjen e sozisë së saj në Gjermani



Ua jep policëve letërnjoftimin fals të Serbisë, arrestohet

